



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 557/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e G.I Kosovko Pomoravlje dega në Ranillug, paraqitur kundër Komisionit e KVV-së në Veliko Ropotovo, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e G.I Kosovko Pomoravlje dega në Ranillug.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 04.11.2013, nga G.I Kosovko Pomoravlje dega në Ranillug, në të cilën ka pretenduar se në fshatin Veliko Ropotovo na u kanë vjedhur shumë vota të subjektit tonë politik G.I Kosovko Pomoravlje, dhe janë të anuluar shumë fletëvotime tona në vendvotimet 3501D/2D, 3501D/1R, 3501D/1D.

PZAP-i, e informoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, se më datë 04.11.2013, për ankesën që është bërë nga subjekti politik G.I Kosovko Pomoravlje dega në Ranillug, dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.11.2013, në ora 12:00.

PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga KQZ sipas afatit të caktuar, ku KQZ në përgjigjen e saj sqaron lidhur me pretendimet për votim të dyfishtë dhe anulim të fletëvotimeve ku thekson se materiali zgjedhor është duke u proceduar sipas procedurave të brendshme të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR), dhe deri në përfundimin e këtij procesi nuk mund të vërtetohet saktësia e pretendimeve ankimore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LQP-sw, parashihet se: *“Mund të apelojnë vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

PZAP-i, gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka prova të mjaftueshme se komisionarët e vendotimeve të cekura kanë bërë shkeljet e pretenduara të rregullave zgjedhore për derisa KQZ ende është duke bërë procedimin e numërimit dhe rezultateve përfundimtare. Prandaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 557/2013 më datën 07.11.2013

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.